



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova

MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs



OPERATORËT E AUTORIZUAR EKONOMIK (OAE)

1 Çka është një OA(E)?

Një OAE mund të përkufizohet si një operator ekonomik i cili konsiderohet i besueshëm, në kontekstin e procedurave doganore të tij dhe për këtë arsye ka të drejtë të gëzojë përfitime të caktuara në të gjithë Kosovën.

Programi OAE është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe ndërmarrjet e mëdha dhe pa marrë parasysh rolin e tyre në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

2 Kush mund të jetë një OAE?

Neni 10.A KDA-së përcakton se statusi i „OAE” mund të epet sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin për çdo OE të themeluar në territorin doganor të Kosovës, kjo kërkesë themelore nënkupton plotësimin e (2) kushteve:

- Aplikuesi duhet të jetë operator ekonomik
- Aplikuesi duhet të jetë i krijuar në territorin doganor të Kosovës

Kush është një “operator ekonomik” OE:

- Në këtë kontekst operatori ekonomik nënkupton personin i cili, në rrjedhën e biznesit të tij, është i përfshirë në aktivitetet e mbuluara nga legjislacioni doganor.

3 Mbajtësi i statusit të OAE ka të drejtë për:

- Numër më i vogël i kontrolleve të dokumenteve dhe kontrolleve fizike
- Trajtim me prioritet i dërgesës në rast të përzgjedhjes për kontroll
- Akses më i shpejtë dhe më i lehtë tek thjeshtëzimet
- Mundësi për të kërkuar një vend të veçantë për kontroll
- Lehtësime fakultative më të mëdha në procedurën e thjeshtëzuar

Përse ia vlen të kesh Certifikatën OAE dhe Autorizimin për Procedurë të Thjeshtëzuar?



4 Llojet të OAE-ve

Tre lloje të certifikimit të OAE;

- AEO D** - thjeshtësime doganore;
- AEO S** - siguria dhe mbrojtja;
- AEO F** - kombinim i plotë i a) dhe b) - rekomandohet për kompanitë që rregullisht përdorin thjeshtëzimet doganore dhe që duan të përfitojnë nga lehtësirat.

a) OAE D thjeshtësime doganore - lëshohen për çdo biznes që përmbush kriteret e pajtueshmërisë doganore, ka standarde të duhura të mbajtjes së regjistrave, ka qëndrueshmëri financiare dhe standarde praktike të kompetencës ose kualifikime profesionale që lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e kryer.

b) OAE S siguria dhe mbrojtja - lëshohen për çdo biznes që i plotëson kriteret e pajtueshmërisë doganore, ka standarde të duhura të mbajtjes së regjistrave, ka qëndrueshmëri financiare dhe që mban standarde të duhura të sigurimit dhe të sigurisë.

5 Cilat janë kriteret për t'i konsideruar aplikacionet?

- Sistem i kënaqshëm të menaxhimit komercial dhe kur është e nevojshme, të dhënat e transportit, të cilat lejojnë kontrollet e duhura doganore;
- Aftësi paguese financiare e dëshmuar;
- Kur është e aplikueshme, standarde të duhura të sigurisë dhe mbrojtjes;
- Standardet praktike të kompetencës ose kualifikimeve profesionale të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin e kryer (kur aplikoni për thjeshtim të doganave të OAE-së).

6 Zinxhiri ndërkombëtar i furnizimit

Zinxhiri ndërkombëtar i furnizimit paraqet procesin nga fillimi deri në fund të një perspektive doganore p.sh nga mallrat e prodhimit të destinuara për eksport deri në dorëzimin e mallrave të blerësi në një territor doganor (brenda apo jashtë territorit doganor të Kosovës);

Akterët kryesor dhe përgjegjësitë e tyre në zingjirin ndërkombëtare të furnizimit, nga perspektiva doganore që aplikojnë për një status të OAE janë si më poshtë:

- importuesi;
- eksportuesi;
- prodhuesi;
- transportuesi i mallrave;
- pronarët e depove;
- agjenti doganor;
- transportuesi;
- të tjerë.

7 Baza Ligjore për OAE

- Ligji Nr. 04 / L- 099 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Nr.03 / L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, neni 10.A; GZRK Nr. 14, 01 qershor 2012
- Udhëzim Administrativ MF(DK) 38/2017



OPERATORËT E AUTORIZUAR EKONOMIK (OAE)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova

MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

Dogana e Kosovës
Rr. Rexhep Krasniqi 49
Prishtinë, Republika e Kosovës
0800 50095
Tel. 038 540 350
Fax. 038 540 836
www.dogana-ks.org
email: hq@dogana-ks.org